



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 239 / Prot.

Durrës, më 9.2.2022

VENDIM

Nr. 5, datë 9.2.2022

"Për miratimin paraprak të detajimit të përdorimit të ardhurave të vitit 2022, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës "

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", nenit 38 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 137/2020, datë 16.11.2020 "Për buxhetin e vitit 2021", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor", Udhëzimit të përbashkët nr. 20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor", kërkesat e paraqitura nga Njësitë Kryesore dhe Drejtoritë, relacionit të hartuar nga Drejtoria e Administrimit Financiar, Vendimit nr. 3, datë 27.01.2022 të Rektoratit, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 09 / 02 / 2022,

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të detajimit të përdorimit të ardhurave të pritshme, për vitin 2022, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas tabelës bashkëngjitur .
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. ~~Kecanela~~ **SOTIROFSKI**

